



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:222007
Datë: 14.12.2021
Numri i dokumentit: 02508656

C.nr.101/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, e përbërë nga gjyqtari individual Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: B.B. nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Safet Voca nga Mitrovica, kundër të paditurës: S... me seli në Mitrovicë të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Lirije Bajrakatri, baza e kontestit: Kompensim i te ardhurave personale, pas mbajtjes së seancës kryesore dt. 01.12.2021, me dt. 10.12.2021, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B. nga Mitrovica dhe **DETYROHET** e paditura që paditësit të i'a kompensoj pagat e pa paguara për periudhën dt. **17.04.2017 e deri me dt. 08.12.2017**, në vendin e punës Mjek Specialist në Kardiologji të e paditura, në shumën prej 634.00€ për muaj, apo në shumën e përgjithshme prej 4,913.00€, me kamatë ligjore prej 8% dhe atë nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (09.09.2019) e deri në ditën e pagesës definitive, të gjitha këto në afatë prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

DETYROHET e paditura t'ia paguajnë paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 798.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi fillimisht me dt.09.09.2019, ka parashtruar padi kunder të paditurës, për kompezimin e pagave të pa paguara. Kjo Gjykate me Aktgjykimin C.nr.858/2019 të dt. 16.03.2020 e ka refuzuar kërkespadinë e paditësit sa i përket kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën kohore dt. 17.04.2017 e deri me dt. 08.12.2017, në shumë të përgjithshme prej 4,913.00€, si dhe kamatën ligjore sipas mjeteve monetare të deponuara nga qytetaret për periudhën një vjeqare pa destinim të caktuar e deri në pagesën definitive të detyrimit, nga arsyet e dhena në aktgjykim.Paditësi i pa kënaqur me Aktgjykimin e lartëcekur brenda afatit ligjor me dt. 18.05.2020, ushtron ankesë pranë kësaj gjykatë, e për Gjykatën e Apelit të Kosovës, për arsyet e cekura në ankesë.

Apelit e Kosvës në Prishtinë, pas pranimit të ankesës së paditësit, të njëjtën e aprovon në tërsi si të bazuar, dhe lënden C.nr.858/2019 e kthen në rivendosje në kete Gjykatë, per arsyet e cekura ne aktvendimin AC.nr. 3534/2020, të dt. 13.01.2021.

Gjykata duke vepruar sipas udhezimeve te Gjykates së Apelit, ka caktuar seancën me dt. 05.10.2021, në të cilën i autorizuari i paditësit e ka precizuar padinë sa i përket të paditurit duke theksuar se palë e paditur duhet të jetë S... në Mitrovicë, në seancat e shqyrtimit kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkespadiës si dhe thënjeve të cekura më lartë. Konsideron se nga provat material te cilat gjinden në shkresat e lëndes, deklarata e paditësit të dhënë në cilësin e palës, deklartën e Dr.V.S. në cilësi të dëshmitarit u vërtetua baza juridike gjegjësisht kërkespadija e paditësit, përkatësisht fakti se paditësi për periudhën kohore kontestuese ka punuar te e paditura dhe ka ofruara sghërbime si mjek specialist në repartin e internos për pacientet e këtij spitali, ashtu kërkojm nga gjykata që të aprovohet padia dhe kërkesëpadija si e bazuar dhe ta obligoj te paditurën kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore 17.04.2017 e deri me 08.12.2017 në vendin e punës Mjek Specialist ne Kardiologji, në shumë prej 634.00€, në muaj apo shumë e përgjithshme prej 4,913.00€, si dhe përfitimin e humbur për periudhën sa ka punuar, me kamat ligjore 8% dhe atë nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në ditën e pagesës definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatë prej 7 ditësh, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të përpilimit të padis shumen prej 104.00€, për përpilimin e ankesës shumë prej 104.00€, për përfaqësim në katër seanca shumë prej nga 135.00€, në emër të taksës për padi shumë prej 20.00€, si dhe në emër të taksës për ankesë shumë prej 30.00€, e gjithsejt shumë prej 798.00€.

Përfaqësuesja e të paditues në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare të cilën e dorzoi në formë të shkruar, deklaroi: e kundërshton në tërsi të pa bazuar padinë dhe kërkespadinë e paditësit, për arsye se paditësi sipas marrveshjes gojore më drejtorin e atëhershëm të S... Dr. H.B. janë pajtuar që paditësi të bëjë punë vullnetare, pa pagesë tek e paditura. Më tutje vazhdon duke theksuar se sa i përket refuzimit gjenë mbështetje ligjore në dispozitat e Ligjit të Punës. Duke u mbështetur në këto dispozita dhe faktin se paditësi me S... nuk ka pas të lidhur kontratë punë për kryrjen e detyrave të caktuara për peridhën kontestuese, nuk mund të bëhet kompensimi pasi që për tu bërë kompensimi duhet të egzistoj kontrata e punë se lidhur në mes të paditësit dhe S... nga e cila kontratë do të buronin të drejtat dhe detyrimit e palëve dhe me të cilën do të provonte bazën juridike të kërkesëpadiës. Ud i drejtorit ekzekutive në deklarimin e dhënë në seancën e dt. 02.11.021 vërteton se paditësi është pajtuar që të kryej punë vullnetare deri në hapjen e konkursit për pranimin e mjekeve dhe ajo ka ndodhur. Po ashtu thekson se bazuar në shkresën e Shefes së repartit e cila gjendet në shkresat e lëndes ajo përmend vetëm punët që I ka kryer në repart (për të cilat është pajtuar në mënyrë vullnetare ti kryej) nuk vërtetohet me prova konkrte peridha e punës, koha e sakt e punës, orari I plotë se paditësi a ka punuar vazhdimisht apo kohë pas kohë, sa kohë ka kaluar në punë dhe meqenëse nuk saktësohen të gjitha këto nuk mund të kërkohej kompensimi sipas kontratës që e ka tani. Gjithashtu deklaroi se nuk ka qenë prezente kur drejtori është marr vesh me paditësin të kryej punë

vullnetare për të padituren, gjithashtu nuk ka dëshmi që e vërtetojn një fakt të till. Andaj bazuar në të lartëcekurat I propozon gjykatës që padisa dhe kërkespadia e paditësit të refuzohet në tërsi si e pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të dt. 01.12.2021 nxori dhe administroi këto prova materiale: Vendimi mbi themelimin e Marrdhënjes së Punës e dt. 08.12.2017, Kontrata e punës e lidhur në kohë të pacaktuar në mes të paditësit dhe të paditurit S... në Mitrovicë e dt. 08.12.2017, Kërkesa e paditësit drejtuar të paditures për pagimin e të ardhurave personale e dt. 24.07.2019 për peridhën kontestuese, Njoftimi I shefes së reaptit të internos në S... në Mitrovicë, Dr. V.S. drejtuar drejtorit ekzekutive të S... të dt. 11.12.2017, Kërkesa e paditësit drejtuar UD Drjtorit ekzekutive në S... të dt. 11.12.2017, Deklartat – dëshmitë e Kolegëve të punës – shefave të repartëve pranë S... në Mitrovicë, të cilat janë dhënë me dt. 02.11.2021.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Faktet jo Kontestuese:

Fillimisht paditësi me dt. 25.07.2019 i'u është drejtuar të paditurit lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore duke filluar nga dt. 17.04.2017 e deri me dt. 08.12.2017 në shumën e përgjithshme prej 4,913.00€, lidhur me shërbimet të cilat i ka kryer si Mjek Specialist Kardiolog në S... në Mitrovicë, e të cilat shërbime i ka kryer në marrveshje me Drejtorin Ekzekutive të Spitalit Dr. H.B. dhe Shefen e Repartit të Internos zonjën V.S. , fakt ky I cili nuk është kontestues e të cilin gjykata e vërtetoi duke u bazuar në Kërkesën e Nr.prot. 1487 të dt. 25.07.2019.

Nuk është kontestues fakti se në mes paditësit dhe te paditurës kanë lidhur kontratë pune me afat te caktuar për periudhën kohore dt. 01.02.2017-16.04.2017, për vendin e punës Mjek specialist në Kardiologji, ky fakt vërtetohet nga kontrata e dt. 02.02.2017.

Po ashtu për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësi edhe pas përfundimit të kontratës se punës ka vazhduar të punoj pa kontratë pune për periudhën kohore dt. 17.04.2017-08.12.2017, ku ky fakt vërtetohet nga këto prova: Njoftimi i Dr. V.S. , Shefes se repartit te Internos, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv ne S... në Mitrovicë e dt. 11.12.2017, nga kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës për pagesën e te ardhurave personale e dt. 24.07.2019 për periudhën e kërkuar si ne padi, po ashtu këtë fakt e pohon edhe përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor.

Nuk ishte kontestues as fakti sa i përket lartësise së pagës mujore të paditësit prej 634.00 euro, nga se ky fakt nuk u kontestua nga palët ndërgjyqese dhe

nga kjo arsye Gjykata nuk e vleroi të nevojshme nxjerrjen e ekspertizes financiare.

Gjithashtu nuk është kontestues fakti se paditësi nga data 08.12.2017 është i punësuar tek e paditura me kontratë me afat të pa caktuar, ky fakt vërtetohet nga kontrata e lidhur dhe e nënshkruar me datë 08.12.2017, ne mes paditësit dhe të paditurës si dhe nga vendimi me nr. te protokollit 07/1688 i dt. lëshimit 08.12.2017, lëshuar nga e paditura lidhur me themelimin e marrëdhënies së punës në mes paditësit dhe të paditurës.

Sa i përket çështjes se paditësi ka punuar tek e paditura për periudhën kohore dt. 17.04.2017 e deri me dt. 08.12.2017 tek e paditura, këtë fakt gjykata e bazon në deklaratën e dhënë **nën betim** nga paditësi në cilsi të pales si dhe deklaratat e dëshmitarëve të propozuara nga ana e perfaqësuesit te te paditures, e të cilat deklarata u dhënë **nën betim**.

Paditsi B.B. në cilsi të palës në seancën e dt. 02.11.2021 ka deklaruar se: me vendimin e Ministrisë së Shëndetësis dhe në bazë të kontratës së punës jam punësuar në spitalin e përgjithshëm të Mitrovicës si specialist I kardiologjisë nga dt. 01.02.2017 deri me dt. 16.04.2017. Pas kësaj mua më është ofruar që të vazhdoj punën nga ana e drejtorit ekzekutiv Dr. H.B. , kjo kërkesë është drejtuar nga ana e tij pa kërkuar unë dhe gojarisht më ka thënë që tit ë vazhdoshë punën qysh kam punuar deri në atë ditë në atë reapt dhe kam kryer shërbimet e tjera profesionale deri në atë ditë, dhe për këtë e ka obliguar shefen e repartit që të më vendosë në të gjitha shërbimet e nevojshme në atë repart. E më vonë pas disa muajve më ka vendos në listen e kujdestarve dhe për këtë është paguar dhe nuk kërkon asgjë. Më tutje thekson se kam kërkuar nga drejtori ekzekutiv që të I sqarohet qështja e vazhdimit të kësaj punë, sa i përket kontratës dhe të ardhurave personale për punën që ai kërkonte që të kryej. Gjithëhere I njëjti I ka thënë se unë jam ai I cili vetna këtu dhe të gjitha shërbimet profesionale që do ti kryejsh do të jesh i paguar. Sa i përket qështjes së lartësis së pagës, maqrrvëshja ka qenë që unë të vazhdojë pagën të cilën e posedoja ka qenë në shumë prej **634.00€** pagë mujore. Më tutje thekson se asnjher gjatë bisedave me drejtorin qe ka pasur ky i fundit nuk ia ka përmendur marrvëshjen për kryerjen e punëve vullnetare, por gjithherë ka insistuar se për shërbimet që do ti kryesh do të paguhesh. Pritjet lidhur me pagimin e të ardhurave personlae kanë vazhduar nga ana e paditësit deri sa i ka thënë të presim të alodohen mjetet buxhetore për këtë vitë(atë vitë). Ndërsa krejt në fund I ka thënë se ndoshta me inicimin e procedurës gjyqesore do të kemi më të lehtë pagimin e këtyre pagave. Sa i përket evidencave për shkuar ardhje nga puna, asksuh nuk është nënshkruar në atë kohë përveq që I kemi evidentuar shërbimet profesionale të cilat I kemi kryer secili veq e veq. Po ashtu shefja e repartit në qdo mbledhje e ka potencuar qështjen e pagesave për mua, po ashtu e njëjta i'u ka drejtuar drejtorit me shkresë lidhur me këtë qështje por nuk kemi pasur asnjë përgjigje nga I njëjti. Pas kësaj me dt. 08.12.2017 mua nga tani e paditura më ka lëshuar kontratë në kohë të pacaktuar aty ku I kam kryer shërbimet profesionale ku edhe sot punojë.

V.S. ne cilsi të deshmitares në seancën e dt. 02.11.2021 ka deklaruar: Në spitalin e përgjithshëm të Mitrovicës që nga viti 2016 kam punuar në cilësin e shefes së repartit të internos. Më tutje vazhdon më kujtohet shumë mire Dr. B. ka filluar punën në repartin tonë nuk më kujtohet a ka pas kontratë nga se ajo

është qështje e drejtorit ekkzekutive të spitalit, por e di se i njëjti ka punuar në repartin e internos si mjek specialist i kardiologjisë. Pas skadimit të afatit prej 2 muajsh drejtori ekzekutiv i ka thënë se Dr.B. Në qdo mbledhje që e kemi mbajtur me shefat të reparteve ku ka marr pjesë edhe Dr. H.B. drejtori ekzekutive I siptalit gjithëher e kam inicuar qështjen për pagimin e pagave për Dr.B. dhe përgjigja ka qenë se **do të paguhet në mënyrë retrograde**, kjo ka ndodh në 5-6 herë mbledhje të mbajtura. Gjitashtu konstaton se Dr. B. ka ardhur gjithmonë me rregullë ne pune gjatë kësaj peridhë dhe ka punuar më orar të plotë, duke I kryer të gjitha shërbimet profesionale të cilat i kryen edhe sot. Po ashtu e njëjta sa i përket lartësis që pagës deklaroi se nuk ka të dhëna lidhur me të njëjtën. Une perkunder insistimeve me goje dhe me shkrim qi ia kam drejtuar drejtorit, i njëjti nuk me ka kthyer pergjigje me shkrim , ndersa me goje me ka thene se do ti paguaj ne menyre retrograde.

H.B. ne seancën e datës 02.11.2021 në cilësin e dëshmitarit ka deklaruar: paditësi ka filluar punën në vitin 2017, nuk i kujtohet data se kur ka filluar, më tutje deklaroi se i njëjti është paraqitur në spitali për të kërkuar punë si specialist kardiolog i pa punë. I njëjti thekson se ia ka mundësuar një gjë të till, duke i thënë se mund të filloni punën vullnetare me kujdestari, ku kujdestaria do të paguhet, ndërsa sa i përket pages thekson se ia ka bërë më dije se pa e sjell një vendim nga drejtori SHSKUK në Prishtinë, nuk mundem të bëjë pagesa se nuk je në list të pagave. Tani këtu paditësi ka pranuar të punoj me marrveshje në mënyrë vullnetare.

Gjykata i vlersoj edhe deklaratat e doktorëve, shefave te reparteve : Dr. A.G. Shef I Repartit te Ortopedisë, Dr. R.M. Shef i Repartit te Radiologjise, Dr. Xh.L. Shef i Repartit te Kirurgjise, Dr. B.H. , Shef i Repartit te Dializes, Dr. F.M. Shef i Repartit te Pulmologjise, Dr. A.U. Shef i Repartit te Neurologjise, Dr. R.M. Shef i Repartit te Pediatrise, ku të gjithë të lartëcekurit njëzëri deklarajn: dëshmojnë se kanë qenë prezent në shumë mbledhje të përbashkëta me shefat e repartëve, ku Dr. V.S. – Shefe e repartit të Internos, në prezencë të UD të Drjetorit të S... në Mitrovicë, Dr. H.B. ka potencuar se Dr. B.B. duhet paguar pagat e premtuaraa në formë retrograde nga drejtori i lartëcekur dhe ai çdo herë ka qenë pro këtij mendimi.

Çështja kontestuese mes palëve ishte kompensimi i pagave për punën e kryer pa kontratë.

Paditësi të drejtën tij e mbështet në faktin se ka pasur marrëveshje gojore me Drejtorin Ekzekutiv te S... si dhe me shefen e Repartit të Internos, ku ka vazhduar të punoj për periudhën kontestuese deri në nënshkrimin e kontratës së punës me kohë të pa caktuar.

E padituri i'a konteston paditësit të drejtën e tij në kompensimin e te ardhurave personale, për shkak se paditësi sipas marrëveshjes gojore me drejtorin e atëhershëm te spitalit Dr. H.B. dhe Dr. V.S. , Shefe e Repartit te Internos, janë pajtuar qe paditësi te kryej punë vullnetare- pa pagesë për periudhën e kërkuar sipas padisë.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata duke vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit , e veqanerisht konstatimin se ” **nese paditesi ka punuar te e paditura dhe ajo kete nuk e ka kundërshtuar dhe nuk është punë vullnetare ,atehere paditesi duhet te kompenzohet per punen e kryer dhe se nuk mund te qe puntori te pesoje per shak se punedhenesi nuk i ka ofruar kontrate te punes , ndersa ne anen tjeter i ka pranuar shërbimet e tij**”, e duke ia shtuar kesaj edhe faktin se e paditura ka pranuar që paditsit të ia paguaj kompenzimin për kujdestarit e mbajtura, fakt ky të cilin e kanë pohuar te gjitha palet ndegjyqese dhe deshmitarët, duke u bazuar në të lartcekurat si dhe duke marr parasysh faktin se paditësi me te paditurën nuk kanë pas te lidhur kontratë pune për kryerjen e detyrave të caktuara për periudhën kontestuese, pavarësisht edhe pse është kryer puna, andaj, nga të lartcekurat gjykata e aprovojë padinë e paditësit si të bazuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlersuar se e paditura mban përgjegjësi për kompensim të pagave për periudhën dt. 17.04.2017 e deri me dt. 08.12.2017 për paditësin.

Gjykata vlerëson se vendosja e kësaj çështje juridike kontestuese si në dispozitiv të aktgjykimit sa i përket aprovimit të kompensimit të të ardhurave personale gjen mbështetje ligjore në dispozita e Ligjit të Punës dhe ate neni 12 par.1 i Ligjit të Punës parasheh se “Vazhdimi i punësimit të të punësuarit, nuk konsiderohet si ndërprerje e marrëdhënies së punës, si në rastet e mëposhtme” nën par.1.4 të të njëtit ligji “me pëlqimin e punëdhënësit”, e në rastin konkret i padituri ka shprehur pëlqimin duke ia mundësuar paditësit vazhdimin e marrëdhënjes së punës deri në lidhjen e kontratës, e në rastin konkret meqenëse paditësi ka vazhduar punën pranë të paditures dhe e paditura nuk e ka kundërshtuar vazhdimin e punes dhe dhenjen e shërbimeve profesionale si mjek specialist ne repartin e Internos, vleron se të njëtit i takon e drejta në kompensim të pagave të kërkuara.

Gjykata i vlersoi edhe pretendimet dhe kontestimet e te paditures dhe dëshmin e dëshmitarit Dr. H.B. (sa i perket qështjes se paditsi në periudhën kontestuese ka kryer punë vullnetare), por sipas vlersimit të kësaj gjykate dhe bazuar në udhezimet e gjykates se Apelit, të njejtat në raport me provat tjera te administruara ishin pa ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje lëndore, gjithnjë për arsytet e cekura më lartë.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8 %, i referohet nenit 382 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe si moment të fillimit të kamatës gjykata ka marr datën e parashtrimit të padisë në gjykatë (datë 09.09.2019)

Në lidhje më afatin e përmbushjes vullnetare të detyrimit sipas këtij Aktgjykimi si dhe afatin për Ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedures, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 lidhur me nenin 465.3 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00€, ne emer te perpilimit te ankeses ne shume prej

104 €, për përfaqësim në 4 seanca prej nga 135.00€, në emër të takses për padi shumë prej 20.00€ si dhe në emër të takses për ankesë shumë prej 30.00€.

Nga përmbledhja e fakteve dhe arsyet ligjore të cekura më lart, e konform nenit 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.101/2021, dt. 10.12.2021

GJYQTARI
Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.